



Pranuar / Dorezuar Prijemci/Protolito Received / Delivery	28.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3782/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.754/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardlita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.407/2020 të datës 30.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën A.nr.754/2019 të datës 11.12.2019 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit/Komunës së Ferizajit, në çështjen juridike "kërkesë nga Marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.754/2019 e datës 11.12.2019 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Komunën e Ferizajit në pozitën Asistente administrative e Drejtorit të Departamentit të kulturës , Rinisë dhe Sportit, sipas Akt emërimit të datës 01.06.2013, me datën 11.12.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5750/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me pagesën e përvojës së punës nga viti 2014 e deri vitin 2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitive të Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 24.12.2019 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje ne ankesë në Komunën e Ferizajit, ndërsa Këshilli ka pranuar shkresat e lëndës nga

organi i punësimit me datën 13.01.2020 me numër protokoli 74/2020.

Këshilli më datë 17.01.2020 përmes shkresës me numër të protokollit 117/2020, ka njoftuar ankuesen për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 11.12.2020 për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 25.05.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.407/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses [REDACTED] ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së të datës 17.01.2020 dhe detyron të njëjtën që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditëses të datës 11.12.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot.:5750/2019 të datës 11.12.2019 e parashtruar nga ankuesja i përmes postës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 17.01.2020 me numër protokoli 117/2020; Aktgjykimi A.nr.407/2020 i datës 30.05.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 11.10.2019; Kërkesë për komunën e Ferizajit; Ndryshimi i vendimit për përvojën e punës me datë 05.07.2019; Formulari për kërkesë apo ankesë e datës 07.07.2019; Kërkesë e datës 07.06.2019 ; E-mail i datës 02.11.2018; E-mail zyrtar i datës 12.11.2018; Përgjigje në kërkesë nga Udhëheqësja e Personelit e datës 08.11.2019; Vendim i datës 16.07.2015 me nr.246/2018; Kërkesë për Ministrinë e punës dhe Mirëqenies Sociale; Kërkesë për Ministrinë e Administratës Publike-DASHC; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 13.01.2020 me numër protokoli 74/2020bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 01.07.2011; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 01.06.2013; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendimi me nr.246/2015 i datës 06.07.2015 lidhur me pranimin e përvojës së punës; Ndryshimi i vendimit për Përvojën e punës me nr.01-141/19 i datës 05.07.2019; përgjigje në kërkesë e datës 08.11.2019; Formulari për kërkesë apo ankesë e datës 11.10.2019; kërkesë për Menaxheren e Personelit; kopja e letërnjoftimit; Lista për pagesën e të ardhurave personale e datës 22.09.1988; Lista për pagesën e të ardhurave personale e datës 11.04.1989; Vërtetim i datës 06.07.2015;Vërtetim i datës 05.07.2015; Regjistri i datës 01.02.1989; Vërtetimi i datës 21.10.1989; Vendimi i datës 14.09.1989; Vërtetim i datës 14.09.1989; Lista e poenave të punës; Regjistri për pagesën e punës 20.09.1985; Lista e të punësuarve dhe përvoja e punës; Lista e punës mujore; Formulari për kërkesa apo ankesa e datës 07.06.2019; Kërkesë e datës 07.06.2019; Lista e datës 30.09.1990; Lista për pagesën e të ardhurave personale e datës 22.09.1988; Regjistri i punëtorëve në bashkësinë lokale e datës 01.02.1989; Vendimi i datës 14.09.1989; regjistri i vitit 1992; Regjistri i pagesave i datës 27.11.1992; Lista e pagave e muajit janar i datës 10.01.2019 dhe listat e pagave për muajin shkurt, mars, prill dhe maj 2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të datës 01.06.2013 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën Asistente ekzekutive në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Ferizajit.

Ankuesja me datën 11.10.2019 me nr.02-113/01-01124317/19 ka parashtruar kërkesë për Menaxheren e Personelit në Komunën e Ferizajit, lidhur me njohjen e përvojës së punës për vitet 2014 deri në vitin 2019. Lidhur me kërkesën e ankueses, Udhëheqësja e Personelit me datën 08.11.2019 i është përgjigjur ankueses lidhur me pagesën e përvojës së punës, e cila i përgjigjet se përvoja e punës për personat që realizojnë pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës duke u bazuar në shkresën me nr.2489 të datës 14.05.2015 ka filluar të realizohet nga viti 2015 e jo nga viti 2014.

Ankuesja prej vitit 2015 nuk ka sjellë asnjë dëshmi shtesë lidhur me përvojën e punës deri më datën 07.06.2019 me kërkesën me nr.02-113/01-0063953/19 , e cila ka sjellë dëshmi shtesë mbi përvojën e punës. Menaxherja e Personelit në Komunën e Ferizajit bazuar në kërkesën e ankueses i ka përcjellë dëshmitë Ministrisë së Administratës Publike ku edhe është realizuar ndryshimi në listë të pagës. Ankuesja në kërkesë ka kërkuar që ti bëhet pagesa shtesë e përvojës së punës në mënyrë retroaktive prej vitit 2014 deri në vitin 2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , bazuar në provat e lëndës si dhe gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, konstaton se me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave të dëshmimit të përvojës së punës respektivisht me qëllim të pagesës së shtesës mbi përvojën e punës, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 15.05.2015 ka nxjerr Vendim me nr.06/29 me të cilin në pikën 2 ka përcaktuar se *"Njohja e përvojës së punës pas qershorit 1999 dëshmohet përmes njërit nga këto dëshmi:2.5. Dëshmisë mbi përvojën e punës të lëshuar nga Organizatat Qendrore dhe Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare të shoqëruara me dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent"*. Në këtë kuptim , Kolegji vlerëson se ankuesja për njohjen e përvojës së punës për provat shtesë që i ka sjellë me datën 07.06.2019 i është bërë pagesa në bazë të Ndryshimit të vendimit për përvojën e punës të datës 05.07.2019 , ndërsa sa i përket pagesës retroaktive prej vitit 2014 deri vitin 2019 për përvojën e punës, Menaxherja e Personelit pas konsultimit me zyrtar përgjegjës të Ministrisë së Financave ka njoftuar ankuesen se pagesa në mënyrë retroaktive nuk mund të realizohet, dhe mbi këtë bazë të specifikuar më lartë si dhe duke marrë për bazë periudhën prej të cilës kërkohet pagesa e shtesës së përvojës në mënyrë retroaktive nga viti 2014 ndërsa kërkesa është bërë në vitin 2019,kolegji konstaton se tashmë përveç arsyeve të lartshënuara kjo kërkesë tashmë është vjetërsuar nëse marrim për bazë Ligjin e Punës nr.03/L-212 respektivisht nenin 87 të këtij ligji, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor është i pabazuar.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.754/2019, datë 28/06/2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuese;
- ❖ Kryetarit të Komunes së Ferizajit;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajit dhe
- ❖ Arkivat të KPMSHCK-së.

